

VENDIM
Nr.786, datë 26.11.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.238, DATË 13.4.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET E DHËNIES SË LEJES PËR LOJËRAT E FATIT,
KAZINOTË DHE HIPODROMET”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 15 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.238, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave, kapitulli II “Kriteret e dhënies së lejes për kazinotë” ndryshohet si më poshtë vijon:

“II. Kriteret për përzgjedhjen e subjekteve dhe për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë në kazino

A) Kriteret për përzgjedhjen e subjekteve

1. Përzgjedhja e subjekteve, të cilat kërkojnë leje për ushtrimin e veprimtarisë në kazino, bëhet pas një procesi përzgjedhjeje të subjekteve të paraqitura, me një konkurrim të hapur, ku të drejtën për të marrë pjesë e kanë subjektet vendase e të huaja. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) Faza e parë, parakualifikuese;

b) Faza e dytë, përzgjedhja e subjektit fitues.

2. Në fazën parakualifikuese, subjektet që kërkojnë të marrin pjesë në konkurrim, duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentet, origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë se ato janë të organizuara në formë shoqërisht apo grupime shoqërisht, me objekt veprimtarie në fushën e kazinove, si dhe aktin e themelimit të shoqërisë dhe statutin.

b) Dokumentet, origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë se nuk janë në proces falimentimi, likuidimi a në ndonjë proces të ngjashëm, në vendin ku kanë selinë qendrore apo në vende të tjera, ku ushtrojnë veprimtarinë.

c) Një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove, nëse ka, të dhënë nga organi përkatës i vendit ku ato kanë selinë qendrore, nëse një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni i shtetit ku kanë selinë qendrore apo të vendeve të tjera ku ushtrojnë veprimtarinë në fushën e kazinove.

ç) Deklaratat për burimin e kapitalit dhe të shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove në vendin tonë.

d) Vërtetimin se nuk kanë detyrime të natyrës fiskale apo të natyrave të ngjashme, kundrejt shtetit të tyre apo shteteve të tjera ku ato ushtrojnë veprimtarinë si për shoqërinë, edhe për çdo subjekt në rast grupimi.

3. Njoftimi për konkurrimin për fazën e parë parakualifikuese të publikohet të paktën në një gazetë të huaj me qarkullim ndërkombëtar dhe në dy gazeta që botohen në vendin tonë, në dy numra radhazi, dhe duhet të përmbajë:

a) Vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve parakualifikuese;

b) Zonën dhe numrin e kazinove për çdo zonë ku lejohet të ushtrohet veprimtaria e kazinosë në vendin tonë;

c) Gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;

ç) Mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;

d) Vendin, orën dhe datën e shqyrtimit të dokumenteve.

Dokumentet për fazën parakualifikuese duhet të paraqiten në tri kopje, njëra prej të cilave origjinale, në zarf të mbyllur.

4. Shoqëria, së bashku me dokumentet e fazës parakualifikuese, të paraqesë edhe autorizimin e personit, që përfaqëson shoqërinë apo grupimin, i cili ka nënshkruar dokumentet parakualifikuese, duke marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga procesi i konkurrimit.

5. Pas përfundimit të fazës së parë nisin procedurat për fazën e dytë të konkurrimit. Për këtë fazë bëhet njoftim, i cili u dërgohet të gjitha shoqërive të përzgjedhura nga faza e parë

parakualifikuese, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

Njoftimi për pjesëmarrjen në fazën e dytë përmban:

- a) Vendin, orën dhe datën e dorëzimit të dokumenteve;
- b) Formën dhe mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;
- c) Gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;
- ç) Vendin, datën dhe orën e zhvillimit të procedurave të shqyrtimit të dokumenteve.

6. Subjektet të cilat kalojnë fazën e parë parakualifikuese, kanë të drejtë të vazhdojnë fazën e dytë të konkurrimit dhe për këtë fazë duhet të paraqesin edhe këto dokumente:

- a) Planbiznesin për zhvillimin e veprimtarisë së kazinosë;
- b) Planzhvillimin nga pikëpamja turistike të zonës ku do të ushtrohet kjo veprimtari;
- c) Përvojën e subjektit në fushën e kazinove apo të lojërave të fatit;
- ç) Madhësinë e kapitalit.

Dokumentacioni për fazën përzgjedhëse duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të vulosur e të nënshkruar nga personi, që ka autorizimin për të përfaqësuar shoqërinë a grupimin, i cili merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zhvillimi i procedurave të konkurrimit për pajisjen me leje për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove.

7. Përzgjedhja e subjekteve në të dyja fazat bëhet nga komisioni i vlerësimit të kërkesave, i cili ka në përbërje:

- Drejtorin e Drejtorisë për Zhvillimin e Zonave Turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit	kryetar
- Një përfaqësues nga Drejtoria e Krimit të Organizuar në Ministrinë e Rendit Publik	anëtar
- Dy përfaqësues nga Ministria e Financave	anëtarë
- Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë	anëtar
- Një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë	anëtar

8. Komisioni i vlerësimit të kërkesave bën klasifikimin e subjekteve sipas kriterëve të vlerësimit, të përcaktuara në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të kërkesave deklarojnë, nën përgjegjësinë e tyre, se nuk kanë lidhje apo konflikt interesash me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim.

10. Komisioni, në përfundim, shpall listën e renditjes së pjesëmarrësve në konkurrim, duke filluar nga shoqëria a grupimi që ka marrë numrin më të madh të pikëve dhe ia paraqet Ministrit të Financave për miratim.

11. Subjekti, i shpallur i pari në listën e miratuar, sipas pikës 10 të këtij vendimi, vazhdon procedurën për marrjen e lejes, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet” dhe në këtë vendim.

12. Kur subjekti i shpallur i pari në listë nuk i vazhdon procedurat për marrjen e lejes, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij fitues, skualifikohet nga Ministri i Financave.

B) Kriteret për dhënien e lejes për kazinotë

Ministri i Financave, me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, i jep lejen organizatorit të kazinosë, të përzgjedhur sipas shkronjës “A” të këtij kapitulli, për një periudhë kohe 15-vjeçare, pasi të ketë plotësuar këto kushte:

a) Të jetë regjistruar në regjistrin tregtar si shoqëri anonime, me objekt ushtrimin vetëm të veprimtarisë së kazinove dhe të lojërave të fatit.

b) Të garantojë në çdo rast fituesit e lojërave në kazino, gjë që nënkupton se duhet të ketë ngurtësuar në një llogari të veçantë bankare një shumë prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, e cila zhbllokohet vetëm me urdhër të Ministri të Financave, me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, pas deklarimeve të bëra nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve nga organizatori.

c) Të deklarojë themeluesit e shoqërisë, ortakët, drejtuesit dhe personelin. Këta persona nuk duhet të kenë qenë të dënuar për vepra penale në fushën e krimit ekonomik.

ç) Të ketë personel të kualifikuar në ushtrimin e veprimtarisë së kazinove dhe të lojërave të fatit, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, i cili dorëzohet në çastin e paraqitjes së kërkesës drejtuar Komitetit të Lojërave të Fatit.

d) Të paraqesë rregulloren përkatëse për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të lojës në kazino.

dh) Të ketë një marrëveshje paraprake me njërën nga bankat me seli në territorin e Republikës

së Shqipërisë për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave.”.

II. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Tabela e vendimit nr.786, datë 26.11.2004 botuar në Fletoren Zyrtare nr.87

Tabela nr.1

Tabela e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit	Pikët e vlerësimit Totali 100 pikë
1. Planbiznesin për zhvillimin e veprimtarisë në kazinotë ku aplikohet	10
2. Planzhvillimin nga pikëpamja turistike e zonës ku do të ushtrohet kjo veprimtari	40
3. Përvoja e subjektit në fushën e kazinove apo të lojërave të fatit	30
4. Madhësia e kapitalit në lekë	
30 000 000-1 000 000 000	8
Mbi 1 000 000 000	12